



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 97/2 Prot

Tiranë, më 23.05.2022

V E N D I M

Nr.74, datë 23.05.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Departamentit të Administratës Publike, për skualifikimin e konkurrentit *** , nga faza e dytë e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë, në TND.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të hetimit administrativ,

Vërej se:

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar me nr. 97 prot., datë 25.01.2022, aplikanti ***** , nëpunës civil në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ka ngritur pretendimin se në mënyrë të padrejtë Departamenti i Administratës Publike e ka skualifikuar nga faza e dytë e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë, në TND.

Aplikanti pretendon se nuk ka arsye të ligjshme për ta skualifikuar, pasi nga Departamenti i Administratës Publike, është konfirmuar nëpunës civil në Kategorinë e Mesme Drejtuese dhe aktualisht kryen detyrën, Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Sipas tij, skualifikimi për shkak të nivelit të pagës, ka çuar në shkelje të “parimit të ligjshmërisë”, si dhe diskriminim për shkak të gjëndjes ekonomike.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, u shqyrtua dokumentacioni shkresor që u dërgua nga njësia përgjegjëse, prej nga rezultoi e vërtetuar se:

Konkurenti *****, duke qenë nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND), për vitin 2021.

Ky konkurrim është shpallur nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me përcaktimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësi civil”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, sipas planit për pranim të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2021.

Në përmbajtjen e shpalljes, janë detajuar procedura e aplikimit, rregullat, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët, fazat e procedurës dhe afatet e përfundimit të saj.

Konkretisht, në shpallje është përcaktuar se procedura është e hapur për:

- a) Nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon: *Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të mesëm drejtues ose të barazvlefshëm me to (kategoria e pagës II-b).*
- a) Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon: *Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të lartë drejtues në institucione të pavarura (kategoria e pagës II-a, I-b ose I-a)*

Pra, në raport me sa parashikohet më sipër, në konkursin kombëtar për pranimin në TND, për vitin 2021, mund të marrin pjesë nëpunësit civilë të nivelit të mesëm drejtues, që ushtrojnë funksionin në një pozicion pune me kategorinë e pagës II-b, si dhe nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura apo të qeverisjes vendore, që ushtrojnë detyrën në një pozicion pune me kategorinë e pagës II-a, I-b ose I-a.

Në përfundim të afatit të aplikimit, mbështetur në pikën 8, të kreut IV, të Vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit,

menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, ka kryer vlerësimin paraprak të dosjeve të aplikantëve, nëse plotësohen prej tyre kriteret specifike, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të kreut III, të këtij vendimi dhe të detajuara në shpalljen e publikuar për këtë procedurë.

Gjatë verifikimit të dosjes së aplikantit ***** , u konstatua se ai nuk plotësonte kriterin e kërkuar për përvojën në punë në pozicione të nivelit të mesëm drejtues ose të barazvlefshëm me to, sipas përcaktimeve në shpallje dhe për pasojë ky aplikant, është skualifikuar nga procedura e rekrutimit në fjalë.

Me këtë përfundim të DAP-it, aplikanti ***** nuk ka qenë dakord, duke pretenduar se ai kryen detyrën e Drejtorit të Drejtorisë dhe se Departamenti i Administratës Publike e ka konfirmuar atë nëpunës civil, në kategorinë e mesme drejtuese.

Në lidhje me këtë pretendim, u kryen verifikimet e nevojshme prej nga rezultoi e vërtetuar se: Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr.4793 prot., datë 13.08.2019, e ka emëruar atë, nëpunës civil në pozicionin, *“Drejtore i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (kategoria e pagës IIIa)*.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se pozicionet e shërbimit civil, klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, si dhe në Vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësveinstitucionet në varësi të ministrive të linjës...”*, të ndryshuar, lidhja 6, ku përcaktohet niveli i pagave, u konstatua se pozicionet *“Drejtore Drejtorie”*, për institucionet qendrore të varësisë, të përcaktuara sipas pikës 1/3/A, të këtij vendimi, ku përfshihet edhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, janë të përfshira në kategorinë e pagës III-a.

Rjedhimisht, rezulton që aplikanti ***** , nuk plotëson kriterin e përvojës së punës, të kombinuar me nivelin e pagës, të përcaktuar në shpallje.

Po kështu, referuar edhe parashikimeve të pikës 5, të Kreut II, si dhe pikave 2/1 dhe 2/2 të Lidhjes 2 të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura”*, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se Kategoria III, Klasa III/1, ku përfshihet shefi i sektorit dhe pozicione të barazvlefshme me të, pozicioni i punës Drejtore i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, pozicioni që aktualisht mban aplikanti ***** , pavarësisht emërimit, barazohet me pozicionet e punës së nivelit të ulët drejtues në shërbimin civil.

Nga gjithë sa më sipër, Departamenti i Administratës Publike, për të shmangur parregullsinë në dukje, të krijuar si pasojë e mospërputhshmërisë midis VKM nr. 187, datë 8.3.2017, të ndryshuar, të nivelit të pagave të sipërcituar dhe klasifikimit të nëpunësisë në shërbimin civil, në momentin e publikimit të kësaj procedure, ka përcaktuar qartë pozicionin e punës në kuptim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, të kombinuar me kategorinë e pagës.

Duke vepruar në këtë mënyrë Departamenti i Administratës Publike, ka bërë të mundur transparencën e procesit dhe përcaktimin e aplikantëve të përshtatshëm, për të marrë pjesë në procedurën për pranimin në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues.

Lidhur me pretendimin e aplikantit se skualifikimi i tij ka çuar në shkelje të parimit të ligjshmërisë dhe diskriminim për shkak të pagës, nga analiza e dokumentacionit, rezulton se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim apo shkelje të parimit të ligjshmërisë, apo barazisë.

Kjo për faktin se procedura dhe kriteret e vendosura në shpallje, të cilat duhet të plotësojnë aplikantët për tu kualifikuar, janë në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësi civil”*, të ndryshuar dhe vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe anëtarëve të TND-së”*, të ndryshuar.

Nga ana tjetër, duke ju referuar nenit 9, pika 4, të Kodit të Punës, ku shprehimisht thuhet se: *“...Dallimet, kufizimet, përjashtimet ose parapëlqimet, që bazohen në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë diskriminim kur, për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj”*, arrihet në përfundimin se kriteri i vendosur për nivelin e nëpunësisë dhe pagës, nuk përbën diskriminim, por është një kusht i përligjur që e kërkon natyra e punës dhe veprimtaria që ushtron nëpunësi TND.

Nisur nga sa më sipër, çmohet se pretendimet e paraqitura nga aplikanti ***** , lidhur me ligjshmërinë e vendimit të Departamentit të Administratës Publike, për skualifikimin e tij në mënyrë të padrejtë nga faza e dytë e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, nuk qëndrojnë.

Departamenti i Administratës Publike si njësi përgjegjëse, për të garantuar një proces të rregullt administrativ në përputhje me përcaktimet ligjore në këtë procedurë, ka vepruar në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe nenin 16, pika 6, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të Departamentit të Administratës Publike, për skualifikimin e konkurrentit ***** , nga procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND), për vitin 2021 dhe meqenëse nuk gjenden elementë të kundërligjshëm në këtë veprim administrativ, çështja të arkivohet.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike dhe aplikanti *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha